# DËSHMI ARKIVI

**A-470101**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Opinion nga Lorenc Vangjeli: Ish-shefja e SHISH nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/25/opinion-nga-lorenc-vangjeli-ish-shefja-e-shish-nuk-shantazhoi-median-por-kercenoi-armiqte-e-saj65464/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 19:30:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 18:50:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 18:49:00 UTC → 25 shtator 2026, 18:51:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `20883319cf69b07d108c39790f5b76bb494dd6997440b4017f5f9fbea8d72dd5` |
| TEKSTI | `1055df13dcf84c2c17327c798d10edb3cf82d9045bdf74bce92bd765a99cda57` |
| PAMJA | `34817d2d7e0f4b0c0027bf12d2a5a9b5a29d85e6fa507fa4cdf0a6763be8fd38` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `60d3e1107c6a1b0501c90fba8a659475d1380ede1e18835024be1d7523e37f95` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/60d3e1107c6a1b0501c90fba8a659475d1380ede1e18835024be1d7523e37f95`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KRYESORE OPINION TË FUNDIT

# Opinion nga Lorenc Vangjeli: Ish-shefja e SHISH nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj

25/09/2026 20:50



**Nga Lorenc Vangjeli**

Ish-shefja e SHISH Vlora Hyseni u duk sikur u tradhtua nga nervat kur përmendi dy togfjalësh fatalë: "Agjentë serbë e dhomë hoteli". Pra, jo vetëm tradhti kombëtare si shërbesë, por edhe seks i ndaluar si shpërblesë. U duk gjithashtu edhe si një mënyrë gazmore e mendjelehtë për të relativizuar raportin e saj të mundshëm me të pandehurin e famshëm të dosjes që e ka mbërthyer brenda saj.

"Më akuzojnë mua, por dhe ju jeni njëlloj!". E parë kështu, shpjegimi është shumë sipërfaqësor, padyshim naiv dhe shumë banal për t'u gjykuar si shkarje e gojës që shket meqë nuk puth dot më. Në të kundërt, ajo ishte një fjali krejtësisht e mirëllogaritur. Shantazhi i konsumuar publikisht nuk kishte në shënjestër gazetaren e njohur të kronikës. Reporterja ishte vetëm mikrofoni të cilën zonja Hyseni e përdori për të paralajmëruar luftë, hakmarrje dhe për të kërcënuar "listën e gjatë të armiqve që i kishin bërë gjëmën "çiftit". Ishte njëkohësisht edhe një ofertë e dëshpëruar për te shpëtuar çfarë mundet nga gërmadha penale e morale që i është shembur mbi kokë: Më mbani mbi gropë, ndryshe humnera ju pret edhe juve!

Rrënimi i frikshëm i zonjës Hyseni në vetëm 48 orë dramatike dhe ekspozimi i mesazheve personale të saj me zotin Agasi, është vetëm një episod kulmor dhe i pabesueshëm në një botë të çmendur shqiptare ku të gjithë kanë sekretet e tyre: jo vetëm komunikim me kontakte minimalisht të papërshtatshëm, por edhe mëkate penale, pislliqe njerëzore apo edhe dobësi porno-erotike. Zonja e sekreteve paralajmëroi si paradhënie pikërisht këto thembra Akili, ku shumëkush në Tiranë çalon rëndë. Paralajmëroi dalje në dritë të këtyre "sekreteve" publikë, qe i dinë të gjithë.

Një drejtues disa vjeçar shërbimi padyshim që ka pushtetin e informacionit. Është gjithashtu edhe dëshmitar i dobësive të njerëzve të pushtetshëm në Tiranë. Kur edhe një amator në këtë punë si Agasi, ka tmerruar dynjanë me serinë e regjistrimeve të fshehta që ju kishte bërë "mysafirëve" në zyrën e tij e gjetkë, është e lehtë të imagjinohet se çfarë mund të ketë pasur në kasafortë zonja Hyseni që kishte një ushtri shtetërore informatorësh në dispozicion.

Në zyrën e zotit Agasi ne ish-Bllok, në vilën në një resort në periferi të Tiranës apo dhe në një zonë rezidenciale në plazhin e Durrësit, ka parakaluar një armatë e palavdishme shqiptarësh të pushtetshëm. Mes tyre edhe ministra, deputetë të shumtë të majtë e ca më pak edhe të djathtë, gjyqtarë e prokurorë, drejtues te lartë të policisë, njerëz të rëndësishëm të medias, biznesmenë shumë të njohur që mund të kenë pasur nevojë për forcën e armëve e të tjerë që nëpërmjet armëve si zanat, ishin shndërruar në biznesmenë.

## Kryesore



Nga Inteligjenca Artificiale te Revolucioni i Flamingove në Tiranë, Rama 25 minuta fjalim në OKB: U fabrikua një narrativë e 'pushtimit izraelit' të bregdetit shqiptar
19:37

Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim
09:59

Shiu nuk do zgjasë! Fundjava me diell dhe temperatura vjeshte deri në 27-28 gradë celsius
12:33

FOTO/ Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, taksia përplaset me autobusin me mësues, plagosen tre persona
15:18

Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb
10:27

## Më të lexuarat

"Ku jemi katandisur!"/ Ish-deputeti Murrizi nxjerr videon e sherrit në Durrës: Ky që e rrahin si gomarin në duhan është shefi i Komisariatit Krujë

"Ke kaluar nga zyra e Ergysit që u bëre deputete?"/ Ministrja Ismaili i përgjigjet fjalës së Berishës në Kuvend: Tek Agasi isha bashkë me Argitën

Detaje nga përplasja në rrugët e Durrësit/ Pronari i hotelit që u shemb gjatë tërmetit goditi shefin e komisariatit, si u mbyll ngjarja pa denoncim

Atentati në Sarandë, TCh siguron videon ekskluzive/ Ja momenti kur ekzekutohet "Tani i Ruzhdiut"

"Bëra gabim që qëllova me shishe"/ Delina Fico zbulon për "Shqipëria Live" se çfarë ndodhi në incidentin me protestuesit: Kishin 5 minuta që shanin

"Më goditi me pasqyrë, duke më rrezikuar jetën"/ Rrëfimi i shefit të Komisariatit të Krujës për videon virale ku u përfshi

U sulmua me vezë në Nju York, reagon Rama: Flamurin shqiptar e kam ngritur më shumë se kurrë para botës, pulat histerike që çarten rrugëve ta mbajnë vath në vesh se...

"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në

Kontaktet me Agasin në atë kohë ishin një aset, një mundësi për karrierë në pushtet e biznes, një shans për të zgjidhur probleme, për të qenë pjesë aleancash fluide e për të ndryshuar raporte forcash. Madje edhe brenda partisë që qeveris vendin e kryesisht brenda saj. "Çifti" që shkëmbente pasion, përkushtim e interesa okulte, padyshim që ka shkëmbyer edhe informacione të tilla. Sikur edhe kaq të kishte në dispozicion zonja Hyseni, subjektet e këtyre përgjimeve kanë të drejtën e Zotit t'u prishet gjumi për shumë kohë. Dhe meqë ish-shefja e shërbimit përmendi dhomat në hotele, pa gjumë do të mbeten edhe ata kanë gdhirë netë të bardha, po shumë të bardha, në periferi të Tiranës, në vila luksi të harbuar e në shoqërinë e një listë mbresëlënëse me eskorta shëtitëse VIP. Të cilat prej kohësh, një pjesë të mikpritësve të tyre, i kanë shndërruar në barcaleta pa shumë kripë me dashnorët e rinj.

Fatmirësisht dy prokurorët e dosjes, Altin Dumani dhe Bledar Maksuti dhe së paku një numër mbresëlënës agjentësh të BKH-së, nuk janë në këtë listë. Dhe së paku deri më tani, si përfaqësues të akuzës publike, i kanë të dyshuarit e tyre me hakmarrjen e shtetit në gjykatë.

Ndaj fjalia arrogante dhe brutale që zonja Hyseni derdhi mbi gazetaren Lala, në fakt është një breshëri mitralozi e shkrehur në ajër pikërisht mbi kokat e kësaj turme laramane individësh. Të cilët i bashkon pushteti, paraja, vaniteti, krimi dhe përshtatja me rregullat e liga të stabilizuara për të pasur sukses. Tani e më tej, ata i bën njësh edhe frika nga e nesërmja e panjohur.
Ish-shefja e SHISH nuk hapi kutinë e Pandorës. Ajo dëshmoi se ka pasword-in e saj. Paralajmëroi se së paku mund të prishë gazin e atyre që kanë nisur festën për rrënimin e saj. Madje edhe shumë më shumë se kaq, zonja Hyseni duket se paralajmëron edhe hakmarrjen e të mbyturit që mbyt. Njëlloj siç premtonte në mesazhet e saj plot përkushtim: "Na kanë bërë shumë gjëra, o shpirt! Dua që ata të paguajnë!".

**Top Channel**

kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

"Ky vend e tradhtoi Hashim Thaçin", Rama nga SHBA: Nuk u bë më e mira për George Washington-in e Kosovës

Ekskluzive/ Mbërrin në Shqipëri Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së, Top Channel mëson se kur i dorëzon letrat kredenciale Presidenti Begaj

## Kryesore »



**Dokumentet tronditëse! Hitleri vrau mbesën e tij? Zbulimi i rrallë prej gati 1 shekulli: Ishte i dashuruar me të, debatuan pak para krimit!**

25/09 21:15



**"Trump ka të drejtë, zhvillimi i AI nuk duhet të ndalohet", Rama në OKB: Na nevojitet inteligjencë artificiale e verifikueshme**

25/09 20:30



**Ekskluzive/ Mbërrin në Shqipëri Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së, Top Channel mëson se kur i dorëzon letrat kredenciale Presidenti Begaj**

25/09 20:09



**Rama mesazh për "Revolucionin Flamingo" në OKB: Protestë kundër një armiku fantazmë, u shpikën histori me tradhti kombëtare e provokime fetare**

25/09 19:57



**Gjyqtarët Sandër Simoni dhe Arbena Ahmeti "kokë më kokë" me vota të barabarta, zgjidhen tre anëtarët më të rinj në KLGJ**

25/09 19:50



**Nga Inteligjenca Artificiale te Revolucioni i Flamingove në Tiranë, Rama 25 minuta fjalim në OKB: U fabrikua një narrativë e 'pushtimit izraelit' të bregdetit shqiptar**

25/09 19:37

## Opinion »



**"Urgjenca e SPAK-ut për ta bërë publik arrestimin fsheh një hall të madh"/ Analiza e Filip Çakulit: Vlora Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë**



**Ku janë provat materiale? 96 vrasje – 96 viktima – 96 dosje provash!**

23/09 18:20



**Shqipja ka nevojë për një rinovim digjital**

23/09 13:43

23/09 18:25



Tani i Madh, Topi i Madh

22/09 19:21



Rugova dhe Jusuf Gërvalla, forca e një modeli

22/09 19:20




Dënimet në Hagë: Midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë

20/09 17:57

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News- Vezë drejt Ramës në New York, përgjigjet kryeministri: Asgjë s'më ndal



Top News – Nxënësi me thikë 13 cm në shkollë, terror në klasë, ndërhyn mesuesi



Top News- "Na shpëtoni, po digjemi", anija merr flakë në mes të detit, panik në bord



Top News – Aeroporti 'Silvio Berlusconi'. Milan Malpensa emërohet në nder të ish-kryeministrit




Top Channel/ Rama mban fjalim në OKB, komenton protestat, zbulon qëndrimin për AI



Top Channel/ UET feston 20-vjetorin, dekada e tretë nis me një kampus të ri



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.